



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prudato Received / Delivery	23.01.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	687/2023		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1221/2022/

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen juridike "kontestim konkursi" sipas ankesës me numër A.nr.1221/2022 të datës 19.12.2022 të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1, Nenin 16 paragrafi 3 nën paragrafin 1.1 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundim Procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.1221/2022, të datës 19.12.2022, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja , më datë 19.12.2022 ka parashtruar ankesë më numër protokoli 8201/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 10-521/21 të datës 21.11.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje brenda kategorisë të Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të shkeljeve të parimeve të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe akteve nënligjore për praninë sipas lëvizjes në kategori, mos zbatim i plotë i Vendimit me numër A.nr.694/2022 të datës 13.09.2022 të KPSHCK-së, shkelje të dispozitave ligjore lidhur me aplikimin e gabuar të procedurës së vlerësimit nga intervista më gojë dhe shkelje të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.12.2022 ka proceduar kërkesën e ankueses për përgjigje në ankesë në Ministrinë Drejtësisë. Ndërsa Këshilli më datë 10.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së kërkesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 8201/2022 të datës 19.12.2022 të parashtruara nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 10-521/21 të datës 21.11.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë të Ministrisë së Drejtësisë; Ankesën e datës 16.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë të Ministrisë së Drejtësisë; Emailin e datës 11.11.2022 nga . . . për ankuesen; Emailin e datës 08.11.2022 nga ankuesja për . . . Emailin e datës 08.11.2022 dhe 05.07.2022 nga . . . për ankuesen; Konkursin me Nr. Reference RN0009103 i datës 06.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë për Avokat Shtetëror; Vendimin DBNJ-Nr.18//2022 të datës 23.09.20-22; Njoftimin për përfundimin e verifikimit paraprak; Njoftimin se është përfunduar verifikimi paraprak i datës 19.07.2022; Plotësimin e ankesës datë 22.12.2022; Diplomën me Nr. 2562 të datës 10.10.2011; Certifikatën për provimin e dhënë të jurisprudencës me Nr. 50/2013 të datës 06.07.2013; Vërtetimin e datës 06.06.2022; Akt Emërimit e datës 05.01.2011; Vërtetimin e datës 02.06.2020; Vendimin me numër protokolli 3203/2018 të datës 06.06.2018; Referencën me Nr. 090/08 të datës 08.07.2008; Reference e datës 07.12.2006; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 01.03.1992; Vërtetimin Vr.Nr.554/09 të datës 22.07.2009; Vendimin me numër 1952-1/2007 të datës 05.05.2007; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 13.12.2021, 31.12.2020; Certifikatën e datës 04.06.2018; Certifikatën për periudhën 28-29.10.2010; Certifikatën e datës 23.11.1999; Certifikatën trajnimi për periudhën 14-15.05.2009, për periudhën 26-27.02.2014, për periudhën 12-13.03.2015, për periudhën 29-30.04.2020; Ndryshimin dhe plotësimi i aktit të emërimit me numër protokolli 3559/2014 i datës 19.11.2014; Mirënjohje për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 8416/2022 e datës 23.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 119/2023 e datës 10.01.2023; Lista e pyetjeve e datës 09.11.2022; Vendimin me Nr.08/22 i datës 23.05.2022; Vendimin me Nr.11/2022 të datës 17.10.2022 për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë të Ministrisë së Drejtësisë; Lista e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Lista përfundimtare e përzgjedhjes në listën e ngushtë; Njoftimi i datës 11.11.2022 të Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore lidhur me përfundimin e procedurës pa fitues (e shkaktuar përmes SIMBNJ-se), Njoftimin pa datë, numër dhe nënshkrim të personit gjegjes lidhur me përfundimin e procedimit paraprak (e shkarkuar përmes SIMBNJ-se) dhe Njoftimin e datës 19.07.2022 pa numër dhe nënshkrim të personit gjegjes (e shkaktuar përmes SIMBNJ-se).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankuesit me numër A.nr.1221/2022 të datës 19.12.2022, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së Ministria e Drejtësisë më datë 06.06.2022 ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ) Konkursin me numër reference RN00009103 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës "Avokat Shtetërorë" 5 pozita, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 21.06.2022 deri me 28.06.2022, ndërsa bazuar në listën e ngushtë të datës 19.07.2022 rezultoi se numri i kandidatëve aplikues ka qenë gjithsej dhjetë (10), ndërsa gjashtë (6) prej tyre janë përfshirë në listën e ngushtë

përkatësisht janë vlerësuar që kanë plotësuar kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme formale të përcaktuara me konkurs.

Bazuar në listën përfundimtare të përzgjedhjes të Komisionit të Vlerësimit i themeluar me Vendimin nr.11/12 të datës 17.10.2022, rezulton se asnjëri nga kandidatët nuk është vlerësuar me pikë të mjaftueshëm për t'u shpallur kandidat fitues rrjedhimisht ankuesja ishte vlerësuar me gjithsejtë pesëdhjetë (50) pikë ndërsa në sistemin SIMBNJ janë përshkruar 10 pikë, kështu që mbi bazën e këtij raporti, Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 11.11.2022 ka shpallur Njoftimin lidhur me përfundimin e kësaj procedurë të pranimit pa kandidatë fitues.

Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit, brenda afatit ligjor parashtron ankesë të brendshme të Komisioni i Vlerësimit i cili me Vendimin me numër protokollit 10-521/21 të datës 21.11.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 16.11.2022 si të pabazuar. Kundër këtij vendimi ankuesja ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve të parimeve të Ligjit Nr.06-114 për Zyrtarët Publikë si dhe akteve nënligjore për pranim sipas lëvizjes në kategori, mos zbatim i plotë i Vendimit me numër A.nr.694/2022 të datës 13.09.2022 të KPSHCK-së, shkelje të dispozitave ligjore lidhur me aplikimin e gabuar të procedurës së vlerësimit nga intervista më gojë dhe shkelje të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me këtë proces të lëvizjes brenda kategorisë ka vendosur sipas ankesës së kandidatës _____ ku me Vendimin A.nr.1117/2022 të datës 18.01.2023 ka shfuqizuar Listën përfundimtare të vlerësimit si dhe Njoftimin e datës 11.11.2022 për përfundimin e procedurës së lëvizjes brenda kategorisë për pozitën Avokat Shtetëror, duke e kthyer çështjen në fazën e vlerësimit të Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë.

Andaj, bazuar në gjendjen faktike si me lartë, dhe duke marrë parasysh së objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1221/2022 ka të bëjë me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr. 1117/2022 të datës 18.01.2023, respektivisht ka anuluar në tërësi fazën e vlerësimit të kandidatëve, Kolegji i Këshillit konstaton së objekti i ankesës A.nr.1221/2022 është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, dhe si rrjedhojë Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot, vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1221/2022 të datës 19.12.2022.*


Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1221/2022

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë ;dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

